POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1

Kush është 39-vjeçari me dy emra që u vra te rezidenca ‘Kodra e Diellit’ në Tiranë! U qëllua nga një distancë e afërt

2

Vdekja e të riut shqiptar në rrethana misterioze në Spanjë, ‘gjendet’ zemra e Saimir Sulës! E motra: T'i bëhet ADN! Gjykata e refuzon, duan ta mbyllin pa prova

3

Këngëtari i njohur shqiptar humb nënën: S’të kam dhe njëherë afër meje t’i puthja këmbët deri sa të më shkoje! Shpresoj të kesh qenë krenare për mua

4

Berisha përplaset me Ballën në Kuvend: 12 nëntori është dita e gjyqit popullor! Deputetit i PS: 'Përdhunon' Kuvendin, të merren masa

5

Tragje Shuhet shqipta vdesin foshnjën 2-vjeç, motra dhe mitur! Plagoset bashkësh mjetit (VIDEO)

Lajmi i fundit

Ish-Presidenti Trump kërkesë Gjykatës së Lartë t’ua ndalojë ligjvënësve të marrin deklaratat e tij të taksave

31 Tetor, 22:53

Kronikë

# Atentati në Tiranë/ 39-vjeçari u vra për hakmarrje, e qëlluan sapo la familjen në shtëpi! 2 autorët u futën te ‘Kodra e Diellit’ duke çarë rrethimin e jashtëm

*Hakmarrja dyshohet të jetë një ndër shkaqet që ka çuar në ekzekutimin e 39-vjeçarit Briken Sanajt një natë më parë në Tiranë. Report Tv mëson se* ***vëllai i 39-vjeçarit Briken Sanaj ka plagosur një person*** *në vitin 2012 në Lezhë.*

- VIDEO/ Kjo është makina e shkrumbuar që autorët përdorën për të ekzekutuar 39-vjeçarin te ‘Kodra e Diellit’
- 39-vjeçari u ekzekutua pas dasmës së kushëririt! Autorët i ndoqën lëvizjet nga Lezha në Tiranë
- Report Tv sjell VIDEO-n, kjo është zona ku autori u fut në rezidencën ‘Kodra e Diellit’ dhe më pas qëlloi me breshëri 39-vjeçarin
- Del FOTO, ja kush është 39-vjeçari që u ekzekutua mbrëmjen e djeshme
- Atentat te ‘Kodra e Diellit’ në Tiranë, vritet me breshëri plumbash 39 vjeçari nga Lezha! Gjendet një makinë e djegur në Qafë-Kashar, dyshohet e autorëve (VIDEO)

**Redaksia**
31 Tetor, 08:10 | **Përditesimi: 31 Tetor, 22:33**

**TIRANË-** Hakmarrja dyshohet të jetë një ndër shkaqet që ka çuar në ekzekutimin e 39-vjeçarit Briken Sanajt një natë më parë në Tiranë. Report Tv mëson se vëllai i 39-vjeçarit, Renato (Anton) Sanaj ka plagosur në vitin 2012 një person në Lezhë, pistë e cila nuk përjashtohet nga grupi hetimor se mund të ketë çuar në ekzekutimin e Sanajt. Ende nuk bëhet me dije se për cilën plagosje bëhet fjalë.

Familja e Sanajt jeton ende në lagjen besëlidhja të qytetit të Lezhës, po vetë 39-vjeçari jetonte në Itali, ndërsa mësohet se ishte kthyer në Tiranë pasi kishte qenë në dasmën e një shoku. 39-vjeçari kishte një marrë një apartament me qira në rezidencën ‘Kodra e Diellit’, aty ku edhe u ekzekutua. Vetë viktima Briken Sanaj, apo siç njihet ndryshe edhe si Skerdilajd Sanaj, nuk rezulton me precedent të mëparshëm penal as në Itali dhe as në Shqipëri.

LEXO EDHE:
**Veliaj: Sheshi ‘Skënderbej’ do shndërrohet në Fan Zone për ndeshjet e Kampionatit Botëror 2022**

Report Tv ka zbardhur edhe dinamikën e ngjarjes. Autori është kujdesur që ta qëllojë 39-vjeçarin pa praninë e familjes. Ai i ka ndjekur lëvizjet e 39-vjeçarit nga Lezha në Tiranë, pasi Sanaj kishte qenë në dasmën e një kushëriri në qytetin e Lezhës. Sanaj është qëlluar rreth 20 minuta pasi ishte kthyer nga dasma.

Autori është futur në rezidencë, nga pjesa e pasme të saj, duke çarë rrethimin e jashtëm, pa u përballur me rojet e sigurisë. Autori ka qenë në këmbë, i maskuar dhe me një çantë në dorë, në të cilën mendohet se ka pasur edhe kallashnikovin me të cilin ekzekutoi 39-vjeçarin. Sanaj është qëlluar me breshëri kallashnikovi teksa ishte duke mbyllur makinën, sapo kishte zbritur familjarët në shtëpi. Dyshohet se edhe brenda rezidencës ka pasur informatorë që e kanë ndihmuar autorin të lokalizojë 39-vjeçarin.

Pasi e ka qëlluar Sanajn në një distancë të afërt, autori është larguar sërish nga pjesa e pasme e rezidencës, aty ku e priste një makinë e më pas së bashku me shoferin është larguar për në Qafë Kashar, aty ku u djeg edhe automjeti i djegur. Ende nuk ka asnjë gjurmë të autorëve.

Katër plumba e kanë kapur Sanajn, plagë të cilat i morën edhe jetën. Ai u dërgua për në spital nga shoku i tij, me një makinë tip 'Audi', por ndërroi jetë rrugës për te 'Trauma'.

***Atentati u regjistrua*** një natë më parë rreth orës 23:20 në rezidencën e 'Kodra e Diellit' në Tiranë. Një natë më parë u gjet edhe një makinë e djegur tip 'Benz' në Qafë-Kashar, në afërsi të një biznesi pllakash, e cila dyshohet se i përket autorëve. Targat e mjetit 'AA777GY', i përkasin shtetasin Luan Qanushi, të cilat rezultojnë të vjedhura para disa ditësh në Tiranë. Brenda makinës është gjetur edhe arma tip kallashnikov, me të cilën është qëlluar në drejtim të 39-vjeçarit.

Sipas burimeve, kamerat e sekuestruara kanë filmuar pamje të rëndësishme ku po punohet për zbardhjen e ngjarjes dhe zbulimin e identitetit të autorëve. Ngjarja është referuar në Prokurori për veprën penale "vrasje me paramendim".

***Raportuan për Report Tv dhe Shqiptarja.com, gazetarët Sokol Dema, Elvis Hila dhe Arsen Rusta***

Briken Sanaj dhe foto nga vendi i ngjarjes

**Rendit zhvillimet sipas orarit:** Të Fundit

**Ora 18:00**

### VIDEO/ Kjo është makina e shkrumbuar që autorët përdorën për të ekzekutuar 39-vjeçarin te 'Kodra e Diellit'

Kjo është makina që kanë përdorur autorët gjatë atentatit të Renato (Anton) Sanaj. Makina tip 'Benz' u gjend e djegur në Qafë-Kashar, në afërsi të një biznesi pllakash.

**Ora 12:01**

### E bërë shkrumb e hi, por në makinën që u larguan vrasësit e Sanajt gjenden gëzhojat e kallashnikovit! (VIDEO)

Report Tv ka siguruar pamjet të automjetit të djegur që u përdor mbrëmjen e djeshme nga vrasësit e Briken (Skerdilajd) Sanajt.

Në pamje duket se si është bërë ‘shkrumb e hi’ automjeti tip “Benz”, që u gjet pas ekzekutimit në zonën e Qafë Kasharit duke u djegur, janë gjetur edhe gëzhojat e kallashnikovit me të cilin u qëllua 39-vjeçari.

[Shqiptarja.com]

**Ora 11:13**

## Atentati në Tiranë/ Report Tv sjell VIDEO-n, kjo është zona ku autori u fut në rezidencën ‘Kodra e Diellit’ dhe më pas qëlloi me breshëri 39-vjeçarin

Kjo është zona në rezidencën ‘Kodra e Diellit’ në Tiranë, nga e cila është futur autori, i cili ka ekzekutuar një natë më parë 39-vjeçarin Skerdilajd Sanaj. Autori është futur nga pjesa e pasme e rezidencës, pa u vënë re nga rojet e sigurisë. Pasi ka qëlluar me breshëri kallashnikovi, autori i maskuar është larguar po nga pjesa e pasme e rezidencës, ndërsa është ndihmuar nga një person tjetër me makinë për t’u larguar. Kjo makinë më pas u gjet e djegur në Qafë-Kashar.

Ora 10:25

## E ekzekutua mbrëmë në rezidencën luksoze në Tiranë, fqinjët e njihnin me emër tjetër 39-vjeçarin

Report Tv ka zbuluar të tjera detaje në lidhje me ekzekutimin e 39-vjeçarit Sanaj mbrëmjen e djeshme në Tiranë. Briken Sanaj, njihej nga të tjerët në rezidencë si Skerdilajd Sanaj, ose Skerdi.

Ora 08:43

## DETAJET/ 39-vjeçari u ekzekutua pas dasmës së kushëririt! La familjen në shtëpi, autorët me makinë thyen traun e rezidencës 'Kodra e Diellit' dhe e qëlluan me breshëri plumbash

Të tjera detaje janë zbuluar nga atentati që u regjistrua një natë më parë në Tiranë. Report Tv ka mësuar se 39-vjeçari Briken Sanaj është qëlluar me breshëri plumbash sapo ka lënë familjen në shtëpi. Pasi ka dalë nga garazhi, autorët janë futur në rezidencën 'Kodra e Diellit' me makinë, kanë thyer traun dhe kanë qëlluar në drejtim të 39-vjeçarit. Fatkeqësisht, Sanaj nuk mundi t'i mbijetonte plagëve të marra.

Ora 08:18

## Atentati në Tiranë, del FOTO, ja kush është 39-vjeçari që u ekzekutua mbrëmjen e djeshme

[Shqiptarja.com]

Ky është 39-vjeçari që është ekzekutuar një natë më parë në Tiranë. Report Tv ka siguruar foton e 39-vjeçarit Briken Sanaj, i cili u ekzekutua mbrëmë në rezidencën 'Kodra e Diellit' nga një mjet në lëvizje.

Sl.E./B.K./Shqiptarja.com

**TAG:** vrasja e Briken Sanajt | briken sanaj | Tirane | vrasje me armë zjarri

Komento

## Komente

**flori:** 31/10/2022 15:30

ka plagosur dike i vellai per nje femer,,,pse duhet te vrasesh kit vellain,,,,kjo gje zgjidhej me nje sqarim...nuk shkohet tek armet,,,a i therrisni mendjes o maloke te trashe.....

Përgjigju

> **Gjsjfjd:** 31/10/2022 18:33
>
> Ahahah vtm me kallash dor i zgjidhin keta vellacko dhe pa ju vrar gj t vrasin

**Zamiri:** 31/10/2022 13:16

Cudi si spo degjohen me ktej nga Rolling Hills Se nje u vra , thane vrau vehten!! Dhe disa here jane vjedhur vilat me super lek.. Po si tregojne te gjitha se gjoja siguri maksimale! Po prit se ka prap.. Vetem kriminela e trafikant strehohen ne kto rezidenca Se normal populli thjeshte ska lek per atje !

Përgjigju

**Alb:** 31/10/2022 11:46

Vetum ppsh ka ken per shqiptaret

Përgjigju

**aldo:** 31/10/2022 11:39

cne se ke kodra dillit jetojne edhe prokurora s qenka vend i sigurte fare

Përgjigju

**destan:** 31/10/2022 10:23

Keta derr malokesh te vrasjet e kane mendjen, race e ndyre....

Përgjigju

> **Ninua:** 31/10/2022 15:28
>
> Kure sti iqne ropt

> **Petrit:** 31/10/2022 12:42
>
> Mos e anashkalo orarin e ilaceve.

**Skeni par gje akoma:** 31/10/2022 09:08

Ne keto rezidenzat do ket vrasje pa fund se te gjith kriminelet kan ble shpi aty . Kriminelet dhe keto pseudo vipat e shqiperis

Përgjigju

**Hason Sperdhima:** 31/10/2022 08:52

Nje mut me Pak....Tjetri....

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

## Sondazhi i ditës:
## A duhet të shtohet numri i bashkive në vend?

PO | JO | Nuk kam mendim

## Lajme të tjera

**Rama i përgjigjet Berishës: Mjeranë në shërbim të rublave ruse! Më kanë kushtuar më pak se gjysma e fluturimeve të Non Gratës**

31 Tetor, 15:07

**Fluturimet me charter të Ramës/ Berisha mbledh 'Rithemelimin': Të ngrihet komisioni hetimor qëtë tregojmë fytyrën e vërtetë të regjimit**

31 Tetor, 14:30

**Familja Rugova merr shtetësinë shqiptare, Veliaj: Krenar për kontributin që i keni dhënë Shqipërisë dhe Kosovës**

31 Tetor, 14:08

A UNI
UNON TË U

**Një grup pedagogësh sërish në protestë! Kovaçi: Nëse qeveria nuk na plotëson kërkesat për dy ditë, të mërkurën futemi në grevë urie**

31 Tetor, 11:19



**PS-PD dakord në parim për nismën e qeverisë, Manja te 'Siguria': Po mendojmë amnistinë se janë mbipopulluar burgjet! Opozita: E duam, por për kërkesat e qytetarëve jo të qeverisë**

31 Tetor, 10:52

**Pallati i pa kolauduar lë jashtë 120 familje, banorët protestë përpara Bashkisë së Tiranës, shkak sherri mes ndërtuesit dhe investitorit**

Enxhi Musaj

31 Tetor, 09:34

Pas 4 vitesh në arrati, vihet në pranga 30-vjeçari! I shpallur në kërkim për transportin e 67 kg kanabis! 4 bashkëpunëtorët u arrestuan në 2018 (VIDEO)

31 Tetor, 09:26

Atentat te ‘Kodra e Diellit’ në Tiranë, vritet me breshëri plumbash 39 vjeçari nga Lezha! Gjendet një makinë e djegur në Qafë-Kashar, dyshohet e autorëve (VIDEO)

30 Tetor, 23:18

tirana
EUROPEAN
YOUTH
CAPITAL'22

Veliaj: Kush ndërton në Tiranë ka emër dhe mbiemër, nuk janë anonimë! Ata që shajnë kullat, aty kanë shtëpitë dhe zyrat e tyre

30 Tetor, 13:09

Tiranë/ Mashtruan një vajzë se do i blinin apartament në pallatin ku ata punonin dhe i morën 25 mijë euro! Pranga 37-vjeçarit, një tjetër në kërkim

30 Tetor, 12:23

TIRANË
POLICIA

Me pistoletë e drogë me vete, arrestohet i riu në Tiranë! Si i mori policia informacionet nga inteligjenca informative (EMRI)

30 Tetor, 10:46

Katedralja Ortodokse ‘pushtohet’ nga jazzi dhe poezia, Eda Zari jep mesazhin e vyer pas koncertit madhështor: Të duam muzikën dhe identitetin tonë

Anila Dedaj

29 Tetor, 19:12

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje